

Thirrje për të gjitha Organizatat e Shoqërisë Civile, Aktivistët dhe Liderët e Komunitetit të Fushë Kosovës: Mundësia juaj për të formësuar një të ardhme më të gjelbër është këtu!

ECMI Kosova, në partneritet me USAID, ka kënaqësinë t'ju ftojë JU—organizatat e shoqërisë civile, aktivistët dhe liderët e komunitetit të Fushë Kosovës/Kosovo Polje—të bëheni pjesë e diçkaje të jashtëzakonshme! **Green Fund Facility**, një komponent kryesor i **Recycling Matters Activity Fushë Kosovë/Kosovo Polje**, tani është zyrtarisht i lansuar, duke ofruar mundësi unike për të krijuar ndryshime të vërteta në komunitetin tuaj.

Kjo është mundësia e juaj për të udhëhequr ndryshimin!

Ne besojmë në fuqinë e komunitetit—fuqinë tuaj—për të nxitur përparim domethënës dhe të qëndrueshëm. **Green Fund Facility** ju ofron burimet, financimin dhe mbështetjen për të udhëhequr projekte që promovojnë praktika të qëndrueshme të riciklimit, forcojnë përfshirjen socio-ekonomike dhe fuqizojnë grupet e marginalizuara si komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian (RAE).

Pavarësisht nëse përfaqësoni një OJQ, jeni një lider aktiv i komunitetit apo një organizator lokal, kjo është mundësia juaj për të:

- Zhvilloni dhe Udhëheqni Iniciativa Lokale për Riciklimin: Ndhmoni në promovimin e ndarjes së mbeturinave në burim dhe përmirësimin e proceseve të riciklimit në lagjet tona.
- Fuqizoni mbledhësit joformal të mbeturinave: Mbështetni mbledhësit joformalë të mbeturinave duke u ofruar mjete dhe mundësi për të formalizuar punën e tyre ose për të filluar biznese të qëndrueshme në sektorin e riciklimit.
- Forconi Kohezionin Social: Punoni me komunitetin për të integruar grupet e marginalizuara në sistemet formale të menaxhimit të mbetjeve, duke krijuar mundësi punësimi dhe përmirësuar jetesën.

Pse duhet të përfshiheni?

Duke u angazhuar me **Green Fund Facility**, do të keni mundësinë të:

- Përdorni grante deri në **€10,000** për projekte riciklimi me ndikim, të udhëhequra nga komuniteti.
- Merrni udhëzime dhe mbështetje nga **ECMI Kosova**, me ndihmë praktike në planifikimin e projekteve, shkrimin e propozimeve dhe menaxhimin financiar.
- Bëni një ndryshim të qëndrueshëm në jetën e komuniteteve të marginalizuara, duke kontribuar njëkohësisht në një të ardhme më të gjelbër dhe më të qëndrueshme për **Fushë Kosovën/Kosovo Polje**.

Kjo iniciativë ka të bëjë me bashkimin e përpjekjeve tona për të krijuar një mjedis më të pastër, më të shëndetshëm dhe një shoqëri më përfshirëse. Tani është koha të hidhni hapin përpara dhe të udhëheqni!

Na bashkohuni për lansimin e sesioneve të informimit të Green Fund!

Për të nisur rrugëtimin, **ECMI Kosova** do të organizojë një seri Sesionesh të Angazhimit të Komunitetit. Këto ngjarje janë krijuar për t'ju ndihmuar JU që të merrni të gjithë informacionin, mjetet dhe mbështetjen që ju nevojiten për të aplikuar për financim dhe për të udhëhequr projekte të suksesshme.

Ngjarja Publike e Lansimit - Sesioni i Angazhimit të Komunitetit 1 – Fushë Kosovë

- **Data:** 09.10.2024
- **Koha:** 11:00
- **Vendndodhja:** Recycling Center Hub, Lagjja 028, Fushë Kosovë.
(<https://maps.app.goo.gl/Sr9RZGvSKcGH8qFo9>)
- **Përshkrimi:** Ky sesion është i përshtatur për komunitetet RAE dhe ata që punojnë drejtpërdrejt me ta. Ne do të ofrojmë udhëzime të detajuara mbi aplikimin për financim dhe ndërtimin e projekteve me ndikim. Materialet do të shpërndahen në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Ngjarja Publike e Lansimit - Sesioni i Angazhimit të Komunitetit 2 – I hapur për të gjithë

- **Data:** 15.10.2024
- **Koha:** 11:00
- **Vendndodhja:** Hotel Semitronix, Fushë Kosovë.
- **Përshkrimi:** Një sesion për organizatat e shoqërisë civile dhe liderët e komunitetit për të eksploruar se si mund të udhëheqin projekte inovative për riciklimin dhe zhvillimin e komunitetit.

SI TË APLIKONI?

Green Fund Facility është e hapur për një gamë të gjerë aplikantësh, duke u fokusuar kryesisht në:

- Organizatat e Shoqërisë Civile: OJQ-të dhe grupe komunitare që punojnë në mënyrë aktive për përfshirjen sociale, riciklimin, ose qëndrueshmërinë mjedisore.
- Mbledhësit joformal të mbeturinave: Grupet ose individët që mbledhin materiale të riciklueshme dhe që duan të formalizojnë rolet e tyre ose të fillojnë biznese të vogla në industrinë e riciklimit.
- Liderë nga komuniteti dhe aktivistë: Ata që janë të përkushtuar për të sjellë ndryshime në komunitetet e tyre, duke ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndërtimin e projekteve të qëndrueshme.

**Shënim: Organizatat e regjistruara në Komunën e Fushë Kosovës janë të inkurajuara të aplikojnë dhe njëkohësisht kanë përparësi në procesin e aplikimit.*

Datat kyçe:

- Hapja e Thirrjes: **30.09.2024**
- Afati i fundit për aplikim: **08.11.2024**

Ne do t'ju udhëzojmë gjatë procesit të aplikimit, do t'ju ofrojmë mbështetje për shkrimin e propozimeve dhe do të sigurojmë që të keni gjithçka që ju nevojitet për të dorëzuar një propozim të fortë.

Nëse jeni të interesuar të aplikoni dhe dëshironi të merrni pakon e plotë të thirrjes, ju lutemi dërgoni një email në gff@ecmikosova.org me subjektin: **Kërkesë për Pakon e Thirrjes**.

Përfitoni nga kjo Mundësi Unike!

Kjo është mundësia juaj për të udhëhequr një projekt që do të sjellë një ndryshim të vërtetë—për mjedisin, për komunitetin tuaj dhe për gjeneratat e ardhshme. Le të punojmë së bashku për të krijuar një të ardhme ku riciklimi është pjesë e jetës së përditshme dhe ku asnjë komunitet nuk mbetet pas.

Green Fund Facility është këtu për t'ju mbështetur. Jemi të emocionuar të shohim projektet e jashtëzakonshme që do të udhëhiqni dhe ndikimin që do të krijoni.!

Për më shumë informacion dhe përkrahje:

Vizitoni www.ecmikosova.org, ose kontaktoni drejtpërdrejt me ekipin tonë të Green Fund:

1. **ECMI Kosovo**

Tel: +383 45 815 135

Email: gff@ecmikosova.org

2. **Recycling Support Hub – Fushë Kosovë – Roma Mahalla**

Ridvan Gashi

Tel: +383 49 721 211

Email: ngo.mck@gmail.com

Gëzim Hoti

Tel: +383 49 176 057

Email: gzim.hoti7@gmail.com

Na ndiqni në rrjete sociale për më shumë informata:

- Facebook: <https://www.facebook.com/ecmikosovo>
- Instagram: <https://www.instagram.com/ecmikosova/>
- LinkedIn: <https://www.linkedin.com/in/ecmi-kosova-539386265/>
- Twitter (X): <https://x.com/ecmikosovo>

Së bashku, le të ndërtojmë një të ardhme më të gjelbër dhe më përfshirëse për Fushë Kosovën/Kosovo Polje!